



**Njoftim i Rëndësishëm në lidhje me aplikimet për Mbrojtje Shtesë  
nga Aplikuesit për Statusin e Refugjatit.**

1. Në kuadër të vendimit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian në çështjen e H. N. kundër Ministrit të Drejtësisë, Barazisë dhe Reformave Ligjore të Irlandës dhe Prokurorit të Përgjithshëm, Rregulloret e Bashkimit Evropian (Mbrojtja Shtesë) të vitit 2013 (Nr. 426 S.I. i vitit 2013) janë ndryshuar.
2. Rregulloret e vitit 2015 të Bashkimit Evropian (Mbrojtja Shtesë) (Amendament) (Nr. S.I. 137 i vitit 2015) u japin efekt statusor marrëveshjeve në vijim të cilat pajtohen me vendimin e Gjykatës:
  - Çdo person që bën një aplikim të ri për statusin e refugjatit gjithashtu mund të bëjë aplikim për mbrojtje shtesë në Zyrën e Komisionerit për Aplikimet e Refugjatëve (ORAC).
  - Çdo person i cili aktualisht ka bërë një aplikim për statusin e refugjatit në pritje gjithashtu mund të bëjë aplikim për mbrojtje shtesë te ORAC-u.
3. Këto aplikime për mbrojtje shtesë do të përcaktohen nga ORAC në pajtim me dispozitat e Rregulloreve të Bashkimit Evropian (Mbrojtja Shtesë), të vitit 2013 (Nr S.I. 426 i vitit 2013)(i ndryshuar) dhe do të shqyrtohet nëse aplikimi i personit për statusin refugjat do të refuzohet nga Ministri i Drejtësisë dhe Barazisë.
4. **Çfarë mbulojnë Rregulloret e vitit 2015?**

**Nëse jeni një aplikues lri për mbrojtje shtesë:**

Rregulloret e vitit 2015 parashikojnë se çdo person që bën një aplikim të ri për statusin e refugjatit gjithashtu mund të bëjë një aplikim për mbrojtje shtesë e cila do të shqyrtohet dhe përcaktohet nga Komisioneri nëse aplikimi i personit për statusin e refugjatit do të refuzohet nga Ministri i Drejtësisë dhe Barazisë. Në këtë aspekt, Komisioneri, në përputhje me Rregulloret e vitit 2013 (të ndryshuara) dhe pas intervistës me një aplikues për mbrojtje shtesë, do të përgatisë një raport me shkrim në lidhje me shqyrtimin e aplikimit. Komisioneri do të bëjë rekomandimin te Ministri i Drejtësisë dhe Barazisë nëse aplikuesi është person i pranueshëm për mbrojtje shtesë.

## **Nëse jeni tashmë një aplikues për mbrojtje shtesë:**

Rregulloret e vitit 2015 parashikojnë se çdo person i cili aktualisht ka bërë një aplikim për statusin e refugjatit në pritje gjithashtu mund të bëjë një aplikim për mbrojtje shtesë e cila do të shqyrtohet dhe përcaktohet nga Komisioneri nëse aplikimi i personit për statusin e refugjatit do të refuzohet nga Ministri i Drejtësisë dhe Barazisë. Në këtë aspekt, Komisioneri, në përputhje me Rregulloret e vitit 2013 (të ndryshuara) dhe pas intervistës me një aplikues për mbrojtje shtesë, do të përgatisë një raport me shkrim në lidhje me shqyrtimin e aplikimit. Komisioneri do të bëjë rekomandimin te Ministri i Drejtësisë dhe Barazisë nëse aplikuesi është person i pranueshëm për mbrojtje shtesë.

5. Në rastin e kategorive të personave të përmendur më sipër, aplikimi për mbrojtje shtesë mund të bëhet duke dërguar një formular ORAC të plotësuar SP/04 [Aplikim sipas Rregullores 3A(1) të Rregullores të vitit 2013 të Bashkimit Evropian (Mbrojtja Shtesë) (i ndryshuar) për deklaratën e mbrojtjes shtesë], qoftë

- duke u paraqitur personalisht në Zyrën e Komisionerit të Aplikimeve për Refugjatët, Timberlay House, 79-83 Lower Mount Street, Dublin 2,

### OSE

- duke e dërguar me postë në adresën ORAC Customer Service Centre, Timberlay House, 79-83 Lower Mount Street, Dublin 2.

6. Pasi të keni aplikuar për Mbrojtje Shtesë mund të jepni më shumë informacion duke plotësuar formularin ORAC SP/05 (Informacion i mëtejshëm në lidhje me aplikimin sipas Rregullores 3A(1) të Rregullores së vitit 2013 të Bashkimit Evropian (Mbrojtja Shtesë) të vitit 2013 (i ndryshuar) për deklaratën e mbrojtjes shtesë) dhe ta dërgoni në adresën e mësipërme. Informacioni i mëtejshëm mund të vihet në dispozicion të Komisionerit në çdo kohë nga data e aplikimit deri në përfundim të 15 ditëve pune pas datës së dërgimit nga Ministri i njoftimit të refuzimit të deklaratës së statusit të refugjatit.
7. Rregulloret e vitit 2013 dhe 2015 mund të lexohen të plota në faqen e internetit të Komisionerit të Aplikimeve për Refugjatë në <http://www.ORAC.ie>.

Zyra e Komisionerit të Aplikimeve për Refugjatë

20 prill 2015